

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

*“Blerje oksigjen gaz dhe leng” per Spialin Rajonal Durres”, e ndare ne 2 lote – marreveshje  
kuader, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 muaj*

*Objekti i Lotit 1 – Blerje Oksigjen Leng*

*Objekti i Lotit 2 – Blerje Oksigjen Gaz*

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Gazra mjekësore, 24111500-0**

**Oksigjen ,24111900-4**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**FONDI LIMIT:** (Vlera e Pritshme e Kontratave, për të gjitha lotet) rezulton :  
53’940’384 (pesedhete e tre milion e nenteqind e dyzet mije e treqind e tetedhete e kater) lekë pa tvsh;  
537,736.856 euro( peseqind e tridhete e shtate mije e shtateqind e tridhete e gjashte presje teteqind e  
tesedhete e gjashte) euro pa t.v.sh, sipas kursit te kembimit te bankes se shqiperise se dates 28.06.2024

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave te Lotit I , Oksigjen Leng– 53’269’920 (pesedhete e tre milion e  
dyqind e gjashtedhete e nente mije e nenteqind e njezet e nente ) leke pa tvsh; 531,052.93 (peseqind e  
tridhete e nje mije e pesedhete e dy presje nentedhete e tre) euro pa t.v.sh, sipas kursit te kembimit te  
bankes se shqiperise se dates 28.06.2024

Fondi i limit/vlera e pritshme e kontratave te Lotit II ,Oksigjen Gaz mjekesor– 670’464 (gjashte qind e  
shtatedhete mije e katerqind e gjashtedhete e kater) leke pa tvsh: 6’683.91 (gjashte mije e gjashteqind e  
tetedhete e tre presje nentedhete e nje) euro pa t.v.sh , sipas kursit te kembimit te bankes se shqiperise se  
dates 28.06.2024

(Vlerat jane konvertuar ne EURO, sipas kursit zyrtar te kembimit te Bankes se Shqiperise, date 28.06.2024  
me kurs kembimi 100.31 ).

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### (TE NJEJTA PER TE DY LOTET)

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

**b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

*Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:*

*a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

*b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Certificate ISO 9001-2015 ose ekuivalent, të vlefshme, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, për fushën e aktivitetit të OE/ që përkon/ përputhet me objektin e Prokurimit

2.1.2 Certificate OHSAS 18001:2007, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë . Certificate të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.3 Certificate ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjeksore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa për pikat e mësipërme 4, 5 dhe 6 është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorise së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësive”.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021 ,2022, 2023) ku vlera e tyre të jete jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Shënim\*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilin ofertohej, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 /ose/ 2.14

Kur konkurohet për më shumë se 1 lot, vlera mesatare do të aplikohet mbi shumën totale të vlerës së pritshme të kontratave për lotet që konkurrohet.

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros jo më e vogël se 40% të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

**Argumentimi:** Ky kriter, është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë

*maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;* Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo më e vogël se **40 % e vlerës së fondit limit\* për të cilat konkurron operatori, është një deshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontraten sic është parashikuar nga AK.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** **Deshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

**Shënim\*:** Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / 2.14.**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejmë te percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

#### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është

brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajtimit të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese/MAH, kjo të plotësohet në Shtojcën 2. Listat e Çmimeve të artikujve të DST.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvritimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe kjo kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Kërkohej të paraqitet dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore/ose/autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Kërkohej Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2024 - 2025), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të provojë se nëse shpallet fitues, është në gjendje të sigurojë tankera oksigjeni për të instaluar brenda 10 ditëve nga lidhja e kontratës, pranë Autoriteteve Kontraktore, spitaleve përkatëse, të cilët nuk disponojnë tankera. Kërkohej minimumi 2 tankera sipas nevojave aktuale të Spitalit Rajonal Durrës.

- Ne rastin kur OE i ka në pronesi, duhet të paraqese një dëshmi për pronesine mbi këto tankera (fature blerje ose dokument doganor për importimin e tankerave të oksigjenit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre tankerave) dhe Vertetimin e leshuar, i vlefshëm për vitin 2024 nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë.
- Në rast se tankerat e oksigjenit do të merren me qira, duhet të paraqitet kontrata ose marrveshja paraprake e qirase, shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronesine e pronarit të tankerave të oksigjenit si dhe i vlefshëm për vitin 2024 nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe të sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe të sigurisë.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar në DST.

2.3.6 Gjatë periudhës nga nënshkrimi i kontratës deri në instalimin e tankerave, Operatori i suksesshem duhet të furnizojë AK përfitues me bombula oksigjeni mjeksor të gazte i cili do të konvertohet me sasinë e Oksigjeni mjeksor të lëngët. Oksigjeni mjeksor gaz i përdorur në bombula duhet të jetë i regjistruar.

Për kriterin 7 dhe 7.1 OE duhet të paraqesin një vetëdeklarim.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar në DST.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se gjatë gjithë kohës së afatit të MK, do të ketë gjendje brenda territorit të Shqipërisë një sasi rezerve oksigjeni mjeksor të lëngshëm, jo më pak se 30.000 litra, për mbulimin e nevojave emergjente të spitaleve. Duke qenë se oksigjeni i lëngshëm është jetik, dhe shërben si terapi për pacientet, dhe për të garantuar vazhdimësinë me furnizim në rast të ndonjë situatë të jashtëzakonshme (pandemi, problem në fabrikën e prodhimit, etj.), duhet që subjekti duhet të ketë sasi rezerve për furnizim për minimumi 30 ditë.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar në DST.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te provoje se, ne se shpallet fitues, do te kete ne dispozicion minimumi 50 bombola oksigjeni mjeksor / pako bombola, ne pronesi ose me qira. Per te vertetuar kete kriter, operatori ekonomik duhet te deklaroje se ka ne pronesi kete sasi bombolash.

### **Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e nje vetëdeklarimi**

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

2.3.9 **Operatori ekonomik** duhet te vertetoje se bombolat e oksigjenit, qe do te furnizohen prej tij, plotesojne kushtet teknike te pajisjeve nen presion. Per kete duhet te paraqese vërtetim te leshuar, i vlefshem per vitin 2024, nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit ne fuqi, ku të jene përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

### 2.3.10 **Automjetet :**

Furnizimi të bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me :

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të leshuar nga DPSHTRR.

**Argumentimi:** Ky kriter vendoset ne mbeshtetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Nr	Emertimi Tregetar	Formedoza	Principi activ	Paketimi
1	Pure Oxygen Medical Gas	Medicinal gas x 100%	Oxygen	40 L
2	Pure Oxygen Medical Liquid	Liquid medicinal oxygen x 100%	Oxygen	

### 1. Per Oksigjenin mjekësor të lëngshëm (Bar)

Sipas Farmakopese Nderkombetare, per prodhimin e oksigjenit nga procesi i lengezimit te ajrit, percakton se kerkesa per oksigjenin per perdorim mjekesor duhet te jete minimumi 99.5% v/v oksigjen.

Shenim: v/v % (vellimi i lendes se tretur / vellimi i tretesires) \*100%

### Kushtet e furnizimit.

#### Automjetet

Furnizimi të bëhet me autobotet e furnizuesit të pajisur me :

4. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
5. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
6. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

### Tankerat e Oksigjenit

Tankerat duhet të certifikohen nga **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) dhe duhet ti nenshtrohen inspektimeve sipas afateve te percaktuara ligjore.

Furnizimi dhe depozitimi i Oksigjenit te lenget do te behet ne perputhje me kushtet teknike dhe te sigurise, në tankerat ne pikat e percaktuara nga institucionet spitalore perfituese, te cilat jepen si me poshte:

### Gaz per perdorim mjekesor, i lengshem:

Nr.	Institucioni	Nr. i tankereve	Kapaciteti ne litra	Pronesia	Vend ndodhja
1	Durres	1	5,000	Pronesi e spitalit	Ne ambientet e spitalit
		1	11,000	Pronesi e operatorite konomik	Ne ambientet e spitalit

OE ka detyrimin per certifikimin e Tankerave në Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion), rregjistrimin dhe ndjekjen e kryerjes se inspektimeve sipas afateve te percaktuara ligjore.

Operatori Ekonomik eshte pergjegjies per montimin, kontrollin dhe mirembajtjen ne perputhje me kushtet teknike dhe legjislacionin ne fuqi. Keto tankera, ne varesi te nevojave te AK, do te shtohen ose pakesohen si numer.

Aparatet matese te depoziatave/tankerave te jene te kolauduara nga institucionet kompetente. Me lidhjen e MK, ti vihet dokumentacioni i kolaudit te aparatave matese, grupit te punes te marrjes ne dorezim te mallit nga OE.

### **Kërkesa të veçanta**

1. Brenda 30 ditëve nga lidhja e Marreveshjes Kuader, Operatori Ekonomik fitues, ne marreveshje me institucionin spitalor, duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerave te tij (zevendesimin e tankerave te kontraktorit te vjeter, ose te vete AK) prane AK. Pas instalimit te tankerave, OE fitues duhet te kryeje rregjistrimin dhe certifikimin e tyre prane **Inspektoratit Shteteror Teknik dhe Industrial**.
2. Per periudhen e zgjatjes se punimeve, kontraktori duhet te marrë masat për të mos nderprerë furnizimin me oksigjen të sherbimeve spitalore, qe perdorin vetem oksigjen të lengshëm duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me bombola 30-40 litershe me presion deri ne 125 bar, sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike, sipas koeficenteve perkates, temperatures dhe densitetit.

3. Operatori ekonomik duhet te siguroje, ne rast avarie te tankerit te oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjekesor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për te siguruar gadishmerine e furnizimit me oksigjen te shërbimeve spitalore 24/24 sipas nevojave te AK. Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kesaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike, ne rast nevojash dhe kur duhet.

**Shenim:** Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren sipas pikes 2 duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republiken e Shqiperise.

## **2. PER OKSIGJENIN MJEKËSOR GAZ**

### **Kushtet e furnizimit per Oksigjen Gaz**

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontroleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.

Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me:

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

Furnizimi do behet me bombola 30 - 40 ose 50 litra me presion deri ne 125 bar.

Operatori duhet te garantoje mbajtjen e nje sasive rezerve brenda vendit, 50 bombola, minimalisht per nevojat 30 ditore, ne varesi te vellimit te nje bombule.

Shenim: Oksigjeni i bombolave qe do te perdoren duhet te jete i regjistruar ne AKBPM per tregtim ne Republiken e Shqiperise.

**Afati i levrimit do te jete sipas kerkeses se AK, Spitalit Rajonal Durres.**

**Afati i skadencës:** Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1/2 e kohës ndërmjet dates së prodhimit dhe asaj të skadencës /ose/ jo më pak se 1 vit nga data e lëvrimit të mallit.

Ky Procesverbal u ngarkua ne SPE nga Njesia e Prokurimit sipas modelit te APP, sipas materialit me Nr. 486/3 date 04.04.2024 dhe Nr. Date me titull ” dergim Specifikime teknike dhe fomdi limit per proceduren e prokurimit : “Blerje Oksigjen gaz dhe leng per Spitalin Rajonal Durres “ te dorezuar nga Njesia e Posacme e ngritur me urdherat e brendshem nr.prot.486 Prot.date 11.03.2024 dhe Nr.486/2 Prot date 13.03.2024 i perbere nga specialiste te fushes.

**Njesia e Prokurimit :**